



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

**Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e
Komuniteteve dhe Kthim**

Legjislatura e III-të

Nr. 18/09

Prishtinë, më 27.02.2009, ora 13:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

PROCESVERBAL

nga mbledhja e Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim

Anëtarët e pranishëm të Komisionit: Bojan Stojanović, Sanije Aliaj, Numan Balić, Hafize Hajdini, Kosara Nikolić, Müfera Şinik, Enis Kervan. Xhevdet Neziraj, Zylfi Merxha, Hetem Arifi.

Anëtarët jo të pranishëm: Zafir Berisha, Sadik Idriz, Mursejl Haljilji.

Gjithashtu të pranishëm ishin: moniturores nga Zyra e Presidentit, KDI, OSCE.

Nga shërbimi i sekretarisë: Natasha Prica-Tisma, Vilson Ukaj, Dashurije Canolli.

Kryesues: Bojan Stojanović, kryetar i Komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar dt. 4.02.2009;
3. Shqyrtimi Projektligjit nr. 03/L-043 për parandalimin dhe kontrollin e integruar të ndotjes, me raportin e komisionit funksional - Komisioni për Bujqësi, Pylltari Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, me amendamente;
4. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 03/L-091 për shfrytëzimin, administrimin dhe mirëmbajtjen e ndërtesës në bashkëpronësi, me raportin e komisionit funksional - Komisioni për Bujqësi, Pylltari Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, me amendamente;
5. Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2004/17 për Mbrojtjen e Konsumatorëve, me raportin e komisionit funksional – Komisioni për Ekonomi Tregti, Industri, Energjetik, Transport e Telekomunikacion, me amendamente;

6. **Shqyrtimi i përgjigjes së Ministrisë së Punëve të Brendshme nr. 140 dt. 9.02.2009 lidhur me kërkesën e Komisionit për implementimin e Ligjit për Letërnjoftimin;**
7. **Të ndryshme.**

Kryesuesi, hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendit i ditës miratohet pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar dt. 4 shkurt 2009

Kryesuesi, konstatoi se procesverbali nga mbledhja e dt. 4 shkurt 2009, u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi Projektligjit nr. 03/L-043 për parandalimin dhe kontrollin e integruar të ndotjes, me raportin e komisionit funksional - Komisioni për Bujqësi, Pylltari Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, me amendamente

Kryesuesi, kërkoi nga anëtarët të deklarohen lidhur me projektligjin në fjalë dhe amendamentet e propozuara, nëse mendojnë se ato cenojnë apo shkelin të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

Pasi që nuk kishte vërejtje, Kryesuesi konstatoi se njëzëri, Komisioni nxori këtë:

R E K O M A N D I M

- I.** Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim ka shqyrtuar Projektligjin nr. 03/L-043 për parandalimin dhe kontrollin e integruar të ndotjes dhe ka konstatuar se dispozitat e tij nuk cenojnë dhe nuk prekin të drejtat dhe interesat e komuniteteve.
- II.** Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim ka shqyrtuar raportin me amendamente të komisionit funksional – Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor dhe ka konstatuar se amendamentet nuk cenojnë dhe nuk prekin të drejtat dhe interesat e komuniteteve dhe i rekomandon Kuvendit të miratojë projektligjin me amendamentet e propozuara.

4. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 03/L-091 për shfrytëzimin, administrimin dhe mirëmbajtjen e ndërtesës në bashkëpronësi, me raportin e komisionit funksional - Komisioni për Bujqësi, Pylltari Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, me amendamente

Kryesuesi, kërkoi nga anëtarët të deklarohen lidhur me projektligjin në fjalë dhe amendamentet e propozuara, nëse mendojnë se ato cenojnë apo shkelin të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

Pasi që nuk kishte vërejtje, Kryesuesi konstatoi se njëzëri, Komisioni nxori këtë:

R E K O M A N D I M

- I.** Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim ka shqyrtuar Projektligjin për nr. 03/L-091 për shfrytëzimin, administrimin dhe mirëmbajtjen e ndërtesës në bashkëpronësi dhe ka konstatuar se dispozitat e tij nuk cenojnë dhe nuk prekin të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

II. Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim ka shqyrtuar raportin me amendamente të komisionit funksional – Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, dhe ka konstatuar se amendamentet nuk cenojnë dhe nuk prekin të drejtat dhe interesat e komuniteteve dhe i rekomandon Kuvendit të miratojë projektligjin me amendamentet e propozuara.

5. Shqyrtimi i Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Projektligjit nr. 2004/17 për Mbrojtjen e Konsumatorëve, me raportin e komisionit funksional – Komisioni për Ekonomi Tregti, Industri, Energjetik, Transport e Telekomunikacion, me amendamente

Kryesuesi, kërkoi nga anëtarët të deklarohen lidhur me projektligjin në fjalë dhe amendamentet e propozuara, nëse mendojnë se ato cenojnë apo shkelin të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

Pasi që nuk kishte vërejtje, Kryesuesi konstatoi se njëzëri, Komisioni nxori këtë:

R E K O M A N D I M

- I. Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim ka shqyrtuar Projektligjin nr. 2004/17 për Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe ka konstatuar se dispozitat e tij nuk cenojnë dhe nuk prekin të drejtat dhe interesat e komuniteteve.
- II. Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim ka shqyrtuar raportin me amendamente të komisionit funksional – Komisioni për Ekonomi Tregti, Industri, Energjetik, Transport e Telekomunikacion, dhe ka konstatuar se amendamentet nuk cenojnë dhe nuk prekin të drejtat dhe interesat e komuniteteve dhe i rekomandon Kuvendit të miratojë projektligjin me amendamentet e propozuara.

6. Shqyrtimi i përgjigjes së Ministrisë së Punëve të Brendshme nr. 140 dt. 9.02.2009 lidhur me kërkesën e Komisionit për implementimin e Ligjit për Letërnjoftimin

Kryesuesi, njoftoi se sipas marrëveshjes në Komision, i kemi dërguar shkresë Ministrit të Ministrisë së Punëve të Brendshme për të kërkuar sqarim për moszbatimin e ligjit për gjuhët zyrtare dhe ligjit për letërnjoftimin në komunën e Prizrenit. Përgjigja e marrur ka qenë se për shkaqe financiare nuk po mund të shtypen dokumentet civile në gjuhën turke dhe boshnjake në këtë komunë.

Numan Balić, theksoi se në përgjigjen e ministrit, nuk jepen informacione për zbatimin e këtyre ligjeve në komunën e Prishtinës, Ferizaj, Lipjan. Kërkoi që si Komision të kërkojmë ndërprerjen e lëshimit të dokumenteve civile, deri sa nuk sigurohen formularët në gjuhën amtare të komuniteteve të caktuara. T'i drejtohem me shkresë Qeverisë për të ndarë mjetet e nevojshme financiare për zgjidhjen e problemit.

Müfera Şinik, theksoi se është e papranueshme arsyetimi nga Ministrit për problemin e zbatimit të ligjit për gjuhët dhe letërnjoftimin për shkaqe financiare. Qytetarët ankohen dhe ne nuk mund t'iu japim përgjigje. Do të duhej që Ministria përkatëse të ndaj buxhet që dokumentet civile të shtypen në gjuhën turke në këtë komunë. Kërkoi që komisioni të ndërmarr diçka në këtë drejtim.

Kryesuesi, theksoi si komision do t'i shkruaj shkresë komisionit për Buxhet dhe Financa dhe Komisionit për Siguri për të kërkuar sqarim lidhur ligjet në fjalë, respektivisht për të marrur

përgjigje vlerësimin e kostos buxhetore që bartin këto ligje. Gjithashtu me shkresë do të kërkojmë nga Ministria për Ekonomi dhe Financa të ndaj mjete buxhetore për të mundësuar zbatimin e ligjit.

Numan Balić, theksoi se shkresa drejtuar institucioneve përgjegjëse, duhet të përmbaj atë se dokumentet civile që janë në procedurë që nuk i përgjigjen njerëzve duhet të ndërpriten së shtypuri, si dhe të kërkojmë ndarjen e mjeteve financiare për të mundësuar shtypjen e këtyre dokumenteve në gjuhët zyrtare.

Xhevdet Neziraj, propozoi që të ftohet një përfaqësues nga Ministria e Punëve të Brendshme, për të dhënë sqarime më detale lidhur me kërkesën e Komisionit për implementimin e ligjeve të caktuara.

Sanije Aliaj, duke u ndërlidhur me çështjen, theksoi se do të duhej që si Komision me shkresë përmes Kryesisë së Kuvendit, të kërkojmë nga Qeveria zbatimin e ligjit për gjuhët zyrtare dhe ligjit për letërnjoftimin të miratuar nga Kuvendi i Kosovës

Hetem Arifi, u pajtua me znj. Aliaj që të kërkojmë zbatimin e ligjit. Theksoi se të gjitha Qendrat e Regjistrimit Civil nuk mund të mbyllën për shkak të problemeve të shfaqura. Ministria përkatëse do të duhej të filloj shtypjen e formularëve në gjuhët zyrtare, pastaj letërnjoftimet. Deri në zgjidhjen e këtij problemi, qytetarët mos të aplikojnë për pasje me letërnjoftim. Në këtë drejtim për realizimin e këtyre kërkesave, sipas z.Arifi pengesë të madhe nuk paraqesin mjetet financiare.

Kryesuesi, theksoi se me shkresë do të kërkojmë nga institucionet kompetente dhe përgjegjëse për zbatimin e ligjit

7. Të ndryshme

Kryesuesi, njoftoi se me 4 mars ka planifikuar të zhvillojnë një vizitë në fshatin Dubravë dhe në Komunën e Ferizajit, në bashkëpunim me Ministrin e Ministrisë për Komunitete dhe Kthim dhe Ministrin e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale.

Zylfi Merxha, njoftoi se për shkak të problemeve shëndetësore nuk mund të jetë në këto takime.

Xhevdet Neziraj, kërkoi që në një mbledhje të komisionit të ftohen përfaqësuesit e Zyrës për Komunitete që vepron në kuadër të Kryeministrisë për tu informuar me punën e tyre. Gjithashtu kërkoi të interesim rreth vizitës së premtuar në Zvicër nga Ministria e Punëve të Jashtme.

Numan Balić, mbështeti kërkesat e z. Neziraj për takim me përfaqësuesit e Zyrës për Komunitete dhe lidhur me vizitën në Zvicër. Propozoi që nëse nuk mund të realizohet në Zvicër të shikohet mundësia e realizimit të ndonjë vizitë në një vend tjetër.

Kryesuesi, mbështeti propozimet për një takim me përfaqësuesit nga Zyra për Komunitete dhe se ata do të ftohen në një mbledhje të Komisionit. Ndërsa lidhur me vizitat jashtë, theksoi se në një takim që ka pasur me ambasadorin e OSBE-së ka marrë premtimin për një vizitë në Bruksel. Do të shohim se çfarë mund të bëjmë në realizimin e këtyre vizitave.

Mbledhja përfundoi në ora 13:45

Përgatitur nga
Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryesuesi i Komisionit,

Bojan STOJANOVIĆ